

MBI
AUDITIMIN TEMATIK TË USHTRUAR NË SHKOLLËN E
MESME PROFESIONALE “PETRO SOTA”, FIER

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Shkollën e mesme profesionale “Petro Sota”, Fier** me objekt: *“Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2015 deri më 01.07.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 69, datë 13.07.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 348/10 datë 30.06.2015, i ka rekomanduar Zj. Klotilda Naço, me detyrë Drejtore **Shkollën e mesme profesionale “Petro Sota”, Fier**, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Autoriteti kontraktor nuk ka dërguar në APP një raport të prokurimeve të realizuara, gjatë 4- mujorit të parë të vitit 2015, duke mos respektuar kërkesat e pikës 4, të nenit 12 të LPP, formati dhe përmbajtja e këtij raporti përcaktohen në rregullat e prokurimit.
Rekomandim: Autoriteti kontraktor, të marrë masa, për hartimin e raportit të realizimit të prokurimeve dhe regjistrin të hartuar të realizimit të prokurimeve publike dhe të dërgohen në Agjencinë e Prokurimeve Publike.

2. Gjetje nga auditimi: Autoriteti kontraktor nuk ka administruar nëpërmjet protokollit kërkesat dhe specifikimet përkatëse për mallra, shërbime apo punë nga stafi mësimor dhe mbi bazën e të cilave të hartohet regjistri i parashikimeve të prokurimeve të vitit 2015, në kundërshtim me LPP dhe RrPP. Nuk ka asnjë dokumentacion për kërkesat e sasive të mallrave dhe shërbimeve, sipas nevojave dhe referuar regjistrin të parashikimit të prokurimit, apo nga cila strukturë iniciohet nevoja e prokurimit si dhe llogaritjen e vlerës limit të kontratës. Këto duhet të referohen këtyre burimeve, çmime tregu, çmime të kontratave të mëparshme, çmime të botuara nga INSTAT, si dhe çmime të tjera nga institucionet përkatëse, veprim në kundërshtim me nenin 59, pika 1 dhe 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” .

Rekomandim:

a. Të argumentohen nevojat/kërkesat për prokurim sipas regjistrin të parashikimit të prokurimit, në zbatim të kërkesave të Prokurimit Publik.

b. Nëpunësi autorizues të marrë masat për unifikimin e formës dhe përmbajtjes të dokumentacionit që shoqërojnë kërkesat për prokurim të mallrave, punëve apo shërbimeve të strukturave të institucionit dhe tu dërgohet menjëherë për zbatim.

3. Gjetje nga auditimi: Nuk janë respektuar tre nivelet e kontrollit të përcaktuar në pikën 5, Kreut I të Udhëzimit nr.2 datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pasi nuk ka dokumentacion të nënshkruar nga kërkuesit e mallrave dhe shërbimeve. Dy nivelet e tjera të kontrollit, janë dokumentuar me Urdhërat e prokurimit, proces verbalet e komisionit dhe nënshkrimin e urdhër shpenzimeve nga të dy nëpunësit zbatues e autorizues .

Rekomandim: Nëpunësi autorizues të respektojë tre nivelet e kontrollit për çdo shpenzim, sipas pikës 5 të Kreut I, pikave 140-142 të Kreut III të udhëzimit nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, me dokumentacionin të nënshkruar nga kërkuesit e mallrave dhe shërbimeve.

4. Gjetje nga auditimi: Nuk është hartuar e miratuar gjurma e detajuar e auditimit, e cila përbën bazë për zbatimin e procedurave, që duhet të ndjekin të gjitha strukturat e SHMP në këtë proces, në mbështetje të Urdhrit të Ministrisë të Financave nr. 57 datë 11.6.2014, pika nr.3 në të cilën

përcaktohet që: “Në referim të gjurmës standarde të auditimit, Titullari i çdo njësie publike të qeverisjes së përgjithshme, të hartojë gjurmën e detajuar të auditimit për njësitë që drejtojnë”.

Rekomandim:

-Nëpunësi autorizues dhe zbatues të marrin masa për hartimin e gjurmës së detajuar të auditimit, për prokurimet publike dhe ti paraqesë për miratim në bordin e shkollës.

5. Gjetje nga auditimi: Në transaksionin nr. 14, datë 16.04.2015 në vlerën 115,821 lekë me objekt shpenzimi “Blerje kancelarie”, u konstatua se:

Inicimi i kësaj procedure nga titullari i autoritetit kontraktor është në kundërshtim me pikën 5 të nenit 29, LPP, neni 40 “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël të RrPP”, germa c, Pika 2 e VKM Nr. 918, datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, dhe pikën 8, të Udhëzimit Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, autoriteti kontraktor mund të kryejë prokurimin në rrugë shkresore sipas formularit nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi”, **pra kjo procedure duhej të kryhej në rrugë elektronike.**

- Në transaksionin nr. 21, datë 14.05.2015, në vlerën 99,180 lekë me objekt shpenzimi “Blerje Karburant”, duke marrë parasysh të dhënat e botuara në buletin e APP-së, të marra nga bursa Reuters, **u konstatua se** në caktimin e çmimit të karburantit, nuk janë dhe nuk është bërë asnjë llogaritje, se sa do të merret çmimi i karburantit për të llogaritur fondin limit. Pra për përcaktimin e çmimit të karburantit në momentin e hartimit të UP, nuk është vepruar sipas kërkesave të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreut III, pika 3, germa “b”.

Rekomandim: Nëpunësi autorizues të marrë masa që procedura e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, të bëhet në mënyrë elektronike dhe të sigurohen gjurmët e auditimit për gjithë procedurën në prokurimin me vlerë më të vogël”.

Rekomandim:Titullari i institucionit të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike, për 6 procedurat e prokurimeve me vlerë të vogël, duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike.

6. Gjetje nga auditimi: Janë bërë dalje nga magazina për Drejtorin e shkollës, e gjithë sasia prej 580 litra karburant (diesel PM tollona), **në vlerën 99,180 lekë,** të nënshkuara nga magazinierja dhe **tërheqësi i tollonave Drejtori i Shkollës.** Ky veprim është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, për arsye se, qëllimi i përdorimit të karburantit ishte që mësuesit të paraqesin në shkollat e qytetit dhe në komunat e rrethit të Fierit dhe në qytete fqinje, drejtimet e funksionimit, strukturën, punën që bëhet në shkollë për arsimin profesional dhe drejtori nuk përfshihej në grafikun e miratuar me shkrehën nr. 208/1, datë 13.05.2015 “Shpërndarja e karburantit sipas grafikut”.

Rekomandim:Të administrohen nga personi me përgjegjësi materiale (magazinieri) tollonat e karburantit dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre (fletë dalja) të bëhet në momentin e konsumit, në zbatim të pikës 34 të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

7. Gjetje nga auditimi: Nëpunësi autorizues nuk ka caktuar me urdhër me shkrim znj. Lorena Puska, në pozicionin e arkëtarit,

-Nuk janë mbajtur libri i arkës dhe ditari i arkës i përcaktuar në Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Mandat arkëtimet janë, të pa nënshkuar nga personi që kryen derdhjen e vlerave, të pa nënshkuara nga nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij, pa numër rendor dhe pa numër serial.

- Vlerat monetare nuk janë derdhur në llogarinë e institucionit në Sistemin e Thesarit.

Këto veprime janë kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, “Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlerë”, pikat 62-65 .

Rekomandim:

a.Të regjistrohen në kontabilitet në ditarët përkatës, dokumentacioni i urdhër shpenzimeve dhe i magazinës, për veprimet e arkës të mbahet llogari kontabile të arkës dhe libëri i arkës, në zbatim të nenit 5 dhe 6 të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të pikës 67 të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

b.Të kryen veprimet me para në dorë për arkëtimin e të ardhurave në vlera më pak se 1,000 lekë, në zbatim të pikës 64 të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

c.Të ruhen në kasafortën e shkollës vlerat monetare dhe të barasvlershme me to, si dhe të jenë në përgjegjësi të punonjësit të ngarkuar me veprimet e arkës në vartësi të nëpunësit zbatues, në zbatim të pikës 72 të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Rekomandim: Të kanalizohen nëpërmjet thesarit, të gjitha arkëtimet nga të ardhurat dytësore dhe nga burime të tjera, në zbatim të pikës 2, neni 4 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe pikave 62-65 të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

8. Gjetje nga auditimi: Pagesa e dy punonjësve me vlerë 15,000 lekë në muaj, ose në total në shumën **150,000 lekë** për periudhën 01.01.2015 deri më 23.06.2015 e në vijim, është bërë në kundërshtim me vendimin nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, kreu ii, “paga për efekt të llogaritjes së kontributeve”, pika 3, duke shkaktuar mbi shpenzim në vlerën **98,000 lekë** në shpenzimet e institucionit .

Rekomandim:Bordi i shkollës, të nxjerrë përgjegjësit për pagesën e dy punonjësve në kundërshtim me *vendimin nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”* duke kërkuar dhe arkëtimin e diferencës **98,000 lekë** të përfituar padrejtësisht.

9. Gjetje nga auditimi: Kryetari i Bordit ka sponsorizuar në vlerën 93,600 lekë, me të cilën është mbuluar diferenca në pagesën e dy punonjësve të punësuar jashtë organikës së miratuar. Veç kësaj me sponsorizues, është paguar edhe fatura e datës 25.05.2015, për akses në internet në vlerën 1, 500 lekë, ndaj operatorit ekonomik ABCOM.

Nuk janë zbatuar dispozitat ligjore, pasi sponsorizimet nuk janë dokumentuar dhe kontabilizuar në institucion, në kundërshtim me pikat 2 e nenit 4 të, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” .

Rekomandim:

a.Për të gjitha sponsorizimet apo donacionet e ndryshme, që do të dhurohen shkollës, të merren masa dhe të kryhet dokumentimi i hyrjes dhe përdorimit të tyre, duke zbatuar kërkesat ligjore dhe kryer veprimet nëpërmjet kontabilitetit.

b.Të ngrihet komisioni për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin e aktiveve, bazuar në pikat 81-87 të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

10. Gjetje nga auditimi: Drejtori i shkollës, nuk plotëson kërkesa të posaçme, për arsye se duhet të kishte diplomë të studimeve universitare të nivelit Master Shkencor, (ose të barasvlershme me të), **për një nga profesionet që lidhet me drejtimit profesionale të institucionit, konkretisht:**

- të ketë diplomë universitare në shkenca inxhinieri mekanike dhe elektrike;
- të ketë diplomë universitare në shkencat ekonomike ose në shkenca kompjuterike;
- të ketë diplomë universitare në shkencat ekonomike;

Në këto kushte emërimi i Drejtorit është në kundërshtim me ligjin nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) dhe Udhëzimit të

Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 13, datë 01.04.2015 “Për kriteret dhe procedurat e emërimit dhe lirimit nga detyra të drejtuesve të institucioneve publike ofruese të arsimit dhe formimit profesional”.

Rekomandime: Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të marrë masa, për plotësimin e kuadrit drejtues, sipas kërkesave ligjore dhe veçorive profesionale që kërkohen.

11. Gjetje nga auditimi: SHMP ka 4 mësues jashtë profilit në kundërshtim me Urdhrin nr. 363, datë 16.09.2014 të MAS “Për përcaktimin e nivelit arsimor të mësuesit në Institucionet Publike të arsimit parauniversitar”, si dhe 3 mësues me ngarkesë nën normë, në kundërshtim me udhëzimin nr. 44, datë 16.10.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e MASH nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”.

- Vendimi nr. 4, datë 05.01.2015 i Drejtorit të shkollës, për ngritjen e komisionit të vlerësimit të dosjeve të mësueseve të lëndës Histori Gjeografi, është bërë në kundërshtim me ligjin Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar dhe Urdhrin e MAS nr. 363, datë 16.09.2014 “Për përcaktimin e nivelit arsimor të mësuesit në institucionet publike të arsimit para universitar”, *pasi ky komision funksionon për marrjen e stafit mësimor në punë.*

- Zgjidhja e kontratës së punës për zj. M.N dhe Zj. A.L, është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar. ligjin Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar dhe Urdhrin e MAS nr. 363, datë 16.09.2014 “Për përcaktimin e nivelit arsimor të mësuesit në institucionet publike të arsimit para universitar”.

- Me vendimin nr 273, datë 06.07.2015, Drejtori i Shkollës së Mesme Profesionale, ka vendosur largimin nga puna të zj. J.M me detyrë Zëvendësdrejtores me arsytimin: “Për thyerje të rëndë të disiplinës në punë, grisjen e dokumentit shtetëror në zyrën e titullarit të institucionit dhe thyerje të kodit etik”.

Ky vendim është bërë në kundërshtim me të Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar dhe Urdhrin e MAS nr. 363, datë 16.09.2014 “Për përcaktimin e nivelit arsimor të mësuesit në institucionet publike të arsimit para universitar”. Nga Drejtori i shkollës janë tërhequr në kundërshtim me dispozitat ligjore e nënligjore të fushës, saji 580 litra gazoil me vlerë 99,180 lekë, sasi e cila është rikthyer në magazinë në sasinë 400 litra gazoil, ndërsa pjesa tjetër është dokumentuar si përdorim për praktika mësimore.

- Kontrata e përkohshme e punës e lidhur për periudhën 09.04.2015-30.06.2015, është në kundërshtim me Urdhrin e MAS nr. 363, datë 16.09.2014 “Për përcaktimin e nivelit arsimor të mësuesit në institucionet publike të arsimit para universitar”.

- Vendimi nr. 258/2, datë 19.06.2015 për emërimin në punë të z. B.G, me detyrë mësues në lëndën profesionale drejtimi Elektroteknikë, nuk është konform Urdhrit të MAS nr. 363, datë 16.09.2014 “Për përcaktimin e nivelit arsimor të mësuesit në institucionet publike të arsimit para universitar”, pasi nuk janë ndjekur hapat proceduriale të përcaktuara në udhëzimin e mësipërm.

-Në institucion nuk mbahet regjistri i punonjësve, i cili duhet të pasqyrojë lëvizjet e kryera (hyrje, dalje), pasi deri në momentin e auditimit nuk janë hedhur të dhënat në regjistër, në zbatim të pikave 1 dhe 2, nenit 36 “Regjistri” të Kreut VII “Detyrime të përgjithshme të punëdhënësit” të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar .

Rekomandim: Të krijohet regjistri themeltar sipas dokumenteve origjinale, në zbatim të pikave 1 e 2, neni 36 “Regjistri”. Kreu VII “Detyrime të përgjithshme të punëdhënësit” të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe të rishikohen emërimet e mësuesve që janë jashtëprofilit , duke i sistemuar në profilin përkatës dhe mos cënuar cilësinë e mësimdhënies.

12. Gjetje nga auditimi: Me vendimin nr. 403, datë 27.03.2015 Gjykata Administrative e Shkallës Parë Vlorë, ka vendosur detyrimin e SHMP ti paguajë zj. N.M, dëmshpërblim me 2 dy paga mujore, për shkak të zgjidhjes së menjëhershme dhe të pa justifikuar të kontratës së punës. -të paguajë shpërblim me 3 paga mujore, për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës.

-të paguajë shpërblim për vjetërsi në punë me 4.5 paga mujore **ose gjithsej 571,331 lekë.**

- Me vendimin nr. 599 datë 04.05.2015, Gjykata Administrative e Shkallës Parë Vlorë ka vendosur detyrimin e SHMP ti paguajë zj. D.S, dëmshpërblim me 3 paga mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës konform nenit 143, të kodit të punës **ose në vlerën 180,420 lekë.**

Rekomandim: Bordi i shkollës të nxjerrë përgjegjësitë për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të punonjësve me institucionin, për shkaqe të pa argumentuara dhe të pa mbështetura në dispozitat ligjore në fuqi, duke kërkuar deri zhdëmtimin e vlerës **751,751 lekë**, që detyron shkollën të paguaj nga këto largime të paligjshme e pa procedurë administrative pasi për shkak të këtyre veprimeve, institucioni detyrohet të ekzekutojë vendime gjyqësore.

13. Gjetje nga auditimi: Nuk janë azhurnuar amzat e maturantëve në vitit 2013 deri 2014, në kundërshtim me udhëzimin e për plotësimin e regjistrit të amzave. Në disa raste nuk është plotësuar regjistri sipas modularit standard duke e lënë pa asnjë shënim.

Rekomandim:

a. Të përfundojë hedhja e amzave të vitit shkollor 2013-2014, sipas grafikut të miratuar nga Drejtori i shkollës.

b. Të zbatohet pika 2 e nenit 2 dhe pika 1 e nenit 8 të Ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, për mbajtjen në institucion të regjistrit të posaçëm, për pasqyrimin e kërkesave të paraqitura për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Në regjistrin me nr. 13/1 Teknologji Informacion dhe Komunikim, me kujdestare mësuesen Enkelejda Prifti, rezultoi se:

Në regjistër poshtë mbylles me vizë të kuqe, është shënuar nxënësi më emrin Ermald Prifti, gjë që dallohet edhe nga ndryshimi i shkrimit. Shkrimi i emrit poshtë vizës së kuqe duket qartë në lëndët Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, me numër 35, në lëndën Gjeografi dhe në lëndën Biologji, veprim në kundërshtim me dispozitat normative të sistemit para universitar, neni 90, pika 1 e 8, pasi nuk janë zbatuar procedurat ligjore të regjistrimit të nxënësit. Veç kësaj dokumentacioni i paraqitur nga nxënësi Ermald Prifti nuk është regjistruar nëpërmjet protokollit të Institucionit .

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga arka janë paguar me procesverbal (pa listë pagesa) dy punonjës në vlerën 150,000 lekë (për 6-muaj), pagesa këto për punën e kryer nga punëmarrësi pa listë pagesë, janë në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, dhe VKM nr. 77, datë 28.1.2015 [Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, duke shkaktuar detyrim ndaj administratës tatimore në vlerën 85,932 lekë, nga e cila 51,436 lekë punëdhënësi dhe 34,496 lekë punëmarrësi .

Rekomandim: Nëpunësi autorizues të likuidojë në DRT, Fier **vlerën 85,932 lekë**, detyrimet që rrjedhin për punësimin në institucion (pa paguar detyrimet për kontributin e sigurimeve

shoqërore e shëndetësore dhe të ardhurave nga paga) të dy punonjësve për periudhën Janar–Qershor 2015 e në vijim.

2. Gjetje nga auditimi: Në transaksionin nr. 19, datë 07.05.2015, me vlerë 97,000 lekë, me objekt shpenzimi “Blerje tabelash, si shkrimi i emrit të shkollës, tabela e bazës profesionale dhe dekori i brendshëm i shkollës”, u konstatua se, dalja e aktiveve në vlerën 97,000 lekë me fletë daljen nr. 11, datë 15.05.2015 me adresën “ambienteve të shkollës” është bërë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Nga autoritetit kontraktor, është pranuar fatura e thjeshtë tatimore nr. 33, datë 04.05.2015, në vlerën 97,000 lekë me TVSH, në kundërshtim me Urdhrin e Prokurimit dhe Procesverbalin e testimit të tregut në të cilin është përcaktuar vlera 100,000 lekë me tvsh. Operatori ekonomik “Tonin Lamacaj”, ka përfituar më tepër vlerën e tvsh në vlerën 16,167 lekë .

Rekomandim:Nëpunësi autorizues, të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit ekonomik nga subjekti “T...L...” në vlerën 16,167 lekë, pasi nuk është subjekt i regjistrimit të tatimit mbi vlerën e shtuar, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Aneksi 5, kategoria II dhe VKM Nr. 1058, datë 21.10.2009, “Për përcaktimin e kufirit minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH)”.

3. Gjetje nga auditimi: Në transaksionin nr. 13, datë 16.04.2015, në vlerën 65.000 lekë me objekt shpenzimi “Instalim kompjuterësh” u konstatua se, oferta e paraqitur nga operatorët ekonomik është mbi fondin limit të përcaktuar në Urdhrin e Prokurimit i cili është në vlerën 58,333 pa tvsh ose 70,000 lekë me tvsh, **me diferencë më tepër në vlerën 10,183 lekë**, e cila përbërin dëm ekonomik të arkëtueshëm nga operatori ekonomik .

3.1. Rekomandim:Nëpunësi autorizues, të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit ekonomik nga subjekti “A...K...” në vlerën 10,183 lekë, pasi nuk është subjekt i regjistrimit të tatimit mbi vlerën e shtuar, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Aneksi 5, kategoria II dhe VKM Nr. 1058, datë 21.10.2009, “Për përcaktimin e kufirit minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH)”.

B/1. MASA PËR MOS PËRDORIMIN ME EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluar, u konstatuan se në **6 raste me fond limit 870,000 lekë** (pa TVSh), ka mos përmbushje të rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit, mos përdorim me efektivitet, efencë dhe economicitet të fondeve publike të vëna në dispozicion, si dhe përdorimin me diferencë negative në fondet buxhetore në vlerën 45,450 lekë, veprim në kundërshtim me nenin 1, 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar .

1. Rekomandim: Bordi i shkollës, të marrë masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, economicitet dhe efencë të fondeve publike, për 6 procedurat e prokurimeve me vlerë të vogël, me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën 45,450 lekë, duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në germën “e” dhe “ç”, neni 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ti rekomandojmë Ministrin të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, fillimin e procedurave administrative për dhënien e masës disiplinore, për Zj. K.N, me detyrë Drejtore dhe Znj. L.P, me detyrë sekretare;

D. DËRGIM MATERIALI

Bazuar në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ti kërkohet Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, **të vlerësojë shkeljet e trajtuara** në Raportin Përfundimtar të Auditimit, apo dhe për shkelje të tjera të proçesit mësimor dhe shkeljet që rezultojnë nga ankimet e ndryshme, që janë në kompetencë të këtij institucioni.

Nga Shkolla e Mesme Profesionale “Petro Sota” Fier, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë në proces zbatimi.**

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Shefki Jaupi, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT